



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2022



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i VI-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022

Më 22.12.2022

Në takim prezantuan:

Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës

Zahir Doda , Drejtorja e Arsimit

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Përfajqsuesi i FSK-së

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Fadil Guri , ZKKK

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Mbledhjen e kryesoi Nënkyetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Vetdijsimi i qytetarëve për rrezikun e e përdorimit të mjeteve piroteknike
- 4.Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB për vitin 2023
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë **Halim Shehu** i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Rasti më i rëndë që ka ndodhur në këtë periudhë kohore është një akt vetvrasës që ka ndodhur dy ditë më herët dh janë duke u zhvilluar hetimet për shkakun se pse ka ardhur deri te kjo vetvrasje.

Në periudhën në mes dy takimeve kanë ndodhur gjithsejt 62 raste .

Prej tyre 22 janë vjedhje ,dhunë në familje 7 raste , sulm 6 raste ,aksident trafiku 8 raste lëndime trupore 6 raste falsifikim i parasë 3 raste ,përdorim i armës 1 rast,përdorim i narkotikëve 1 rast shpërdorim i pasuris së huaj 3 raste , një rast vetëvrasje dhe të tjera 4 raste si shkak i dukuris së vjedhjeve është mosprezenca e pronarve të shtëpive por edhe mungesa e stafit Policorë të cilët kohëve të fundit kanë angazhime shtesë .

Te dukuria e dhunës në familje nuk don të thot se është rritë numri por që është bërë një vedijësim në paraqitjen e rasteve .

Të gjithë personat që kanë shfaqë dhunë në familje janë dërguar në paraburgim prej 30 ditësh dhe ndaj tyre do të vazhdojnë masat tjera ligjore .

Gjendja e siguris në përgjithësi është e qetë , me parkingje deri diku është mirë ,gjendja e sigurisw nëpër shkolla me përjashtim të disa zënkave që kanë ndodhur në mes nxënësve është e mirë .

Falë furnizimit me masë drusore të kontrolluar nga Komuna dhe agjensioni i Pyjeve situata është e mirë sa i përket ruajtjes së pyjeve .

3.Vetdijsimi i qytetarëve për rrezikun e e përdorimit të mjeteve piroteknike

Nënkyetari – Jemi në sezonën ku mjetet piroteknike i hasim kudo dhe për këtë prapë fjalën ja japë Komandantit lidhur me atë se a kanë ndonjë planë operativ .

H.Shehu – Sa i përket kësaj qeshtje është ligji 04/L-022 ku i ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike deri në një vendim tjetër që merr qeveria.

Përdorimi i tyre bëhet në mënyr të pakontrolluar dhe në hapsirën ku nuk sigurohet perimetri.
Ne zbatojm ligjin dhe ka ndodhur që edhe u kemi lëshuar gjoba.

Për përdorimin e mjeteve piroteknike ,shitjen e tyre dhe për hapsirat e përdorimit vendosë Qeveria .

Nënkryetari – U tha nga ana juaj që keni munges të stafit Policorë por që duhet bashkarisht me inspektorët Komunal të frekuentohen disa hapsira ku ka grumbullim njerëzish e sidomos nëpër shkolla.

H.Shehu – Lidhur me këtë qeshtje kemi pasur takim edhe me inspektorët Komunal por edhe drejtorët e shkollave mos të hezitojn të kërkojn ndihmën tonë nëse hasim në ndonjë vështërsi sa i përket kësaj qeshtje .

Z. Doda – Përdorimi i mjeteve piroteknike në mënyrë të pakontrolluar më së shumti atakon fëmijët .Mirë që është ligji që ndalon shitjen dhe përdorimin e tyre por që a duhet edhe ne si institucione Komunale të dalim me një vendim duke u bazuar në këtë ligj.

H.Shehu – Është mirë të dilet me vendim ngase për shitjen e këtyre mjeteve në rrugë ilegale është punë e inspektoratit Komunal dhe ne ofrojmë asistencë për të parandaluar shitjen dhe përdorimin e tyre .

Z. Doda – Më e keqja është që disa nxënës këto mjete i përdorin edhe brenda hapsirave të mbyllura të shkollave por që nuk po mundemi të marrim masa radikale ndaj tyre.

Fadil Guri – Nga ky forum ne mundë të dalim me ndonjë rekomandim që duke u bazuar në ligj ndalohet rreptësisht përdorimi i mjeteve piroteknike në hapësirat publike.

Nënkryetari – Ne si Komunë përmes Drejtoris së Arsimit mundë të i shpërndajm njoftimet në qdo shkollë dhe të ngrisim vetëdijen tek nxënësit se përdorimi i këtyre mjeteve është i ndaluar me ligj.

4.Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB për vitin 2023

Nënkryetari – Para se me hapë diskutimin rreth planit deshta të ju njoftoj që Naim Hysa ka propozuar një temë që të futet në plan e kjo temë është menagjimi i emergjencave -Fatkeqësit natyrore .

Fatmir Qaka – Naimi ka propozuar që në mbledhjen e dytë të vitit të ardhshëm në planin e punës të futet kjo temë , kështu që së bashku me Bujarin dhe sektorin e emergjencave mundë të na prezantojnë ndonjë plan sa i përket kësaj teme .

Z. Doda – Propozoj që edhe tema që e trajtuam rreth vetëdijësimit të qytetarëve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike të futet në agjendë të mbledhjes së muajit tetorë me qëllim që të kemi kohë që të ndërmarrim diqka , ose përmes thirrjes publike të angazhojm një OJQ që të ndërmerr ndonjë aktivitet sensibilizues .

Nënkryetari – Me këto propozime që ju dhatë në planin e punës ,kët plan e ofroj për miratim .

Plani u miratua nga të pranishmit me disa ndryshime , i cili plan në mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal në vitin 2023 do të përcillet për miratim së bashku me raportin e punës për vitin 2022 .

5.Të ndryshme

Fatmir Qaka – Edhe pse kemi diskutuar edhe më herët rrethë dukuris së lypsarëve , kjo dukuri është në rritje dhe mendoj që në kuadër të planit të punës të shtjellohet edhe kjo temë dhe me aktivitete konkrete të pengohet kjo dukuri.

H. Shehu – Kjo dukuri më e shpeshtë është të premtëve dhe ata shfrytëzojnë lokalet e frekuentuara por edhe objektet fetare .

Ne kemi pasur edhe aktivitete duke i gjobitur ata dhe mundë të themë se Komuna e Kaçanikut ka më së paku lypsarë.

E. Malsiu – Një temë që ka paraparë grupi punues që ka të bëjë me përgatitjet me sfidat e sezonit verorë propozoj që të zhvendoset nga muaji gusht , ngase gushti është përfundimi i sezonit të verës dhe të trajtohet më herët .

Brengosëse është edhe keqpërdorimi i një personi me aftësi të kufizuara nga një person për shitjen e shamponëve me qka po jep një imazh të keq për organizatën HANDIKOS pasi që edhe ne prodhojm shamponë.

Sh. Abazi – Më intereson të dijë për kamerat e sigurisë në qytet se a janë funksionale .

H. Shehu – Një pjesë e madhe e këtyre kamerave nga koha kur ka pasur punime në rrugët e qytetit janë jashtë përdorimit .

Këto kamera janë pronë e Komunës mirëmbahen nga Komuna dhe përcillen nga Policia.

Fatmir Qaka – Është mirë që pasi të dërgohen ftesat për mbledhje të KKSB , një ditë përpara nga sekretarja e zyrës së Kryetarit të thirren anëtarët që ta konfirmojn prezencën apo jo prezencën e tyre .

Fadil Guri – Po e paraqes një shqetësim të lokalitetit të fshatit Nikaj rreth dëmtimit të arave nga kafshë që nuk kanë mbykqyrje nga pronarët e tyre .

H. Shehu – Kemi pasur këso raste dhe pronarët e kafshëve janë gjobitur .Për këtë përmes administratës e përpiloni një ankesë dhe ne mundë të veprojmë .Pa ankesë me shkrim ne nuk mundë të veprojmë në asnjë mënyrë.

E. Malsiu – Shqetësim për mua është edhe shitja e ushqimeve nëpër shitore , a kan kushte për përgatitjen e ushqimit dhe a kontrollohet kjo dukuri nga inspektorët Komunal.

Nënkryetari:Inspektori sanitarë ka kaluar në nivelin qndrorë dhe me zyre është në Ferizaj dhe për momentin me punën e tij është duke u marrë inspektori i tregut i cili vazhdimisht është në teren dhe raporton për qdo që ka të bëjë me ushqimet nëpër markete dhe me lokalet që përgatisin ushqime.Në mbledhjen e radhës do ta thërras inspektorin e tregut i cili para jush do të raportoj lidhur me këtë qështje.

Z.Doda:javën e kaluar kam marrë pjesë në një takim të nivelit qendrorë dhe është diskutuar qëshhtëja e sigurisë nëpër shkolla .Vendet më të rrezikshme në bazë të një hulumtimi që kanë bërë disa organizata profesioniste që rrezikojnë sigurinë e nxënësve janë pikërisht kafiteritë dhe disa pika ushqimore përreth shkollave.Nga niveli qendrorë shumë shpejtë do të dilet me disa rekomandime për të marrë masa ndaj këtyre pikave që janë bërë shumë shqetësuese.

REKOMANDIMET

-Të zbatohet Ligji 04/L-022 që ndalon përdorimin e mjeteve piroteknike në hapsira publike

-Të organizohen aktivitete vetdijësuese në prandalimin e përdorimit të pakontrolluar të mjeteve piroteknike

-Të bëhen funksionale kamerat e sigurisë në qytet.

Pas rekomandimeve Nënkryetari e shpalli të mbyllur takimin për të u takuar në fund të muajit shkurt 2023, ashtu siq e parasheh plani i punës dhe orari i mbledhjeve të KKSB

Kryesuesi: Nënkryetari i Komunës

z.Sabedin Vishi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka